



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni pranëveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 25.6.2013, në orën 10.30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Duda Balje dhe Kymete Bajraktari.

Mungoi: Justina Pula.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë:, Nuredin Ibishi Keshilltar i Komisionit, Burim Tahiri Mbështetës i Komisionit,

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 19 qershor 2013,
3. Shqyrtimi i kërkesave.,
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 19 qershor 2013

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua me disa vërejtje të deputetëve Kymete Bajraktari, . Rita Hajzeraj – Beqaj, Kurtan Kajtazi.

3. Shqyrtimi i kërkesave

Kryetarja – i njoftoi se kanë për shqyrtim një kërkesë dhe lidhur me këtë i'a kaloi fjalën anëtarëve të Grupit Punues për shqyrtimin e peticioneve.

Kurtan Kajtazi – Theksoi se kjo kërkesë është trajtuar edhe më heret. Ai i njoftoi anëtarët e Komisionit se paraqitësi i kërkesës Adem Emmini nga fshati Lluzhan ka kërkuar kompenzimin e dëmit për fushën e sportit që i është dëmtuar nga bora. Ai po ashtu tha se palës në fjalë i është kërkuar dokumentacioni shtesë dhe lidhur me këtë janë analizuar të gjitha mundësitë mirëpo nuk është e mundur që ti bëhet kompenzimi, po ashtu ai theksoi se edhe komuna në raste të katastrofave nuk është e obliguar ti bëjë kompenzimin e dëmit, kjo është çështje e vullnetit të kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal nëse kanë mjete ti ndihmojnë, mirëpo me akte ligjore nuk është e mundur që të detyrohet Komuna që t'ia kompenzojë dëmin e shkaktuar. Ai tha se pronari është dashur që ta sigurojë objektin në ndonjë kompani sigurimi në mënyrë që të bëhet kompenzimi nga kompania. Ai ishte i mendimi se është mirë që si përgjigje ti kthehet që kjo çështje nuk ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut.

Rita Hajzeraj – Beqaj - Theksoi se pronari ka konsideruar që qfarëdo fatkeqësie natyrore që ndodh komuna është e obliguar që atij t'ia kompenzojë dëmin e shkaktuar. Ajo theksoi se me qëllim që mos ti bëhet e padrejtë kanë kërkuar nga pronari dokumentacionin shtesë dhe është konstatuar se pronari nuk ka të drejtë në kërkesën e tij sepse komuna nuk është e detyruar ta kompenzojë në raste të tilla. Ajo kishte mendim të njejtë me parafolësin se pronari është dashur ta sigurojë objektin në ndonjë kompani siguruese dhe në raste të tilla do ti kompenzohej dëmi nga kompania siguruese. Ajo ishte e mendimit që pronarit ti dërgohet një njoftim në të cilin do njoftohej se pse nuk mund ti kompenzohet dëmi i shkaktuar.

Kryetarja – Theksoi se nuk ka njohuri se a i është drejtuar komunës me këtë kërkesë apo jo dhe ishte e pajtimit me parafolësit se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit.

Pas një debati lidhur me këtë çështje Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione pasi shqyrtoi kërkesën e Adem Eminut për ndihme financiare për renovimin e fushës së sportit e cila është dëmtuar nga bora konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit.

Kryetarja – theksoi se në takimet e radhës duhet të punohet në udhëzuesin për peticione në mënyrë që të jetë e qartë se kur duhet qytetarët ti drejtohen Komisionit e në cilat raste jo.

Rita Hajzeraj – Beqaj – tha se kërkesa e kaluar ka qenë për fshatrat e Pejës, Deqanit dhe Istogut për të cilën i është adresuar Komisionit për Pylltari. Ajo theksoi se duhet që ti kërkohet informacion Komisionit në fjalë që të informoi Komisionin për të Drejtat e Njeriut lidhur me veprimet e ndërmarrura lidhur me kërkesën në fjalë, sepse po i dërgojnë kërkesat për shqyrtim por nuk po marrin përgjigje se cilat veprime i kanë ndërmarrë komisionet e tjera.

Kryetarja – Ishte e mendimit të njëjtë me parafolësen dhe tha se duhet të kërkohen informacione tek komisionet e tjera lidhur me veprimet e tyre për çështjet që i adreson Komisioni për të Drejtat e Njeriut.

4 Të ndryshme.

Kryetarja - Informoi Komisionin se edhe pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit për personat e verbër dhe në kontakt me shoqatën e personave të verbër konstatohet se ky ligj nuk ka filluar ende të zbatohet Ajo po ashtu theksoi se para se të miratohet ligji është ftuar në Komision Ministri i Financave nga i cili është kërkuar sqarim rreth implikimeve bugetore të këtij ligji. Duke marrë parasysh këto rrethana ajo propozoi që të filloj minitorimi i zbatimit të këtij ligji me qëllim që të bëhet një raport dhe të njoftohet Kuvendi që ligji nuk është duke u zbatuar.

Pas një debati lidhur me këtë çështje Komisioni nxori këtë :

V E N D I M

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione vendosi që ta monitorojë zbatimin e Ligjit për personat e verbër dhe formoi Grupin Punues me këtë përbërje ;

1. Kymete Bajraktari – Kryetare,
2. Rita Hajzeraj – Beqaj – anëtare,
3. Kimete Bytyqi – anëtare,
4. Kurtan Kajtazi – anëtar,
5. Albana Gashi anëtare,

Kymete Bajraktari – theksoi se është shumë e qëlluar ideja e monitorimit të këtij ligji sepse ka shumë pengesa në zbatim të tij. Ajo po ashtu theksoi se disa nga ministritë kompetente nuk i kanë nxjerrë aktet nënligjore kurse ato që i kanë nxjerrë ato i kanë tejkaluar kompetencat e tyre sa i përket këtij ligji.

Albana Gashi – tha se lidhur me këtë ligj ajo ka pasur edhe një pyetje parlamentare drejtuar Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me vështirësitë që janë paraqitur siq janë mungesa e buxhetit, mosformimi i Komisionit medikosocial mirëpo ministri e ka paraqitur si problem vetëm mungesën e buxhetit edhe pse para miratimit të këtij ligji është thënë se planifikimi buxhetor do të bëhet për vitin 2013 mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ajo tha se te verbërve u është bërë presion nga partia në pushtet që të pranojnë shumën prej 100 eurove ose do të mbeten pa ligj. Në fillim i kanë detyruar ta pranojnë këtë shumë e mandej as ato nuk iu kane dhënë, pra Qeveria i ka mashtruar të verbërit. Ajo theksoi se deklaratat e tanishme të ministrisë janë se implementimi i këtij ligji do të bëhet me rishikimin e buxhetit që do të bëhet në korrik të këtij viti mirëpo ajo ishte e mendimit se si Komision të dalin me një rekomandim për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa para se të bëhet monitorimi i këtij ligji.

Kryetarja – ishte e mendimit që paraprakisht të bëhet monitorimi i ligjit e pastaj duke marrë parasyshë pasqyrën e krijuar të marrin veprimet e caktuara si Komision. Ajo tha se edhe përkundër faktit që është premtuar se do të ketë buxhet për këtë ligj një gjë e tillë nuk është realizuar dhe pikërisht për këtë arsye është e nevojshme që të bëhet monitorimi i zbatimit të këtij ligji e më pas të dalin me rekomandime.

Kurtan Kajtazi – Duke u bashkangjitur theksoi se është mirë që të bëhet monitorimi i këtij ligji sepse ka ngecur në zbatim mirëpo nuk është vetëm çështja e buxhetit që është shkak i moszbatimit por ka edhe çështje tjera paraprake të cilat i paraprijnë kësaj. Ai tha se institucionet përkatëse nuk i kanë kryer detyrat e veta dhe nuk i kanë nxjerrë aktet nënligjore, pastaj Komisioni medikosocial nuk e ka kryer punën e vet dhe nuk dihet numri i saktë i të verbërve në Kosovë të cilët i marrin pensionet, dhe është mirë që brenda një kohe të shkurtër të takohen me tri institucionet në mënyrë të identifikimit të problemeve sepse ka edhe nene të tjera që nuk po zbatohen dhe duhet të behët një raport dhe të jemi kritik lidhur me këtë situatë para atyre që kanë qenë kompetent ta zbatojnë këtë ligj. Ai tha se kjo shtresë kanë mbetur në gjendje të keqe sepse nuk është vetëm paga por janë edhe beneficionet e tjera të cilat nuk po i shfrytëzojnë akoma.

Rita Hajzerja – Beqaj – tha se Qeveria nuk e ka zbatuar ligjin pastaj nuk është formuar Komisioni Medikosocial. Ajo po ashtu theksoi se pas gjashtë muajve është dashur të nxirren aktet nënligjore. Ajo propozoi që të bëhet monitorimi i zbatimit të këtij ligji dhe pastaj të dalin me rekomandime në mënyrë që të implementohet ligji. Ajo tha se edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji gjendja nuk ka ndryshuar fare sepse ky ligj nuk është zbatuar.

Kymete Bajraktari - si kryetare e Grupit Punues për monitorimin e Ligjit për personat e verbër tha se duhet të punohet intenzivisht në këtë monitorim dhe theksoi se në rast të mungesës së anëtarëve të Grupit Punues ajo do ti realizoi individualisht vizitat.

Kryetarja – I njoftoi Komisionin se edhe pse janë planifikuar gjashtë projektligje të arrijnë në Komision ato ende nuk kanë ardhur dhe pikërisht kjo është arsyeja që ka kohë më shumë për monitorim sepse kur të arrijnë ligjet atëherë është më e vështirë sepse rritet ngarkesa në punët e Komisionit. Ajo po ashtu i informoi Komisionin se projektligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve i cili është i paraparë të arrijë në Komision në dhjetor, është duke u punuar nga Zyra Ligjore dhe në punëtorin e organizuar kanë marrë pjesë Kryetarja dhe nënkryetarja e Komisionit të cilat e kanë dhënë kontributin e tyre. Gjithashtu sa i përket projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Barazi Gjinore ajo tha se pritet që të arrije muajin tjetër dhe kjo është arsye që sa më parë duhet të përfundohet raporti i monitorimit të Ligjit për Barazi gjinore.

Albana Gashi – Lidhur me ankesën e qytetareve të fshatrave të komunës së Ferizajt të cilët nuk kanë sinjale të televizioneve nacionale tha se si Komision ju kanë drejtuar Komisionit të Pavarur për Media mirëpo ata janë përgjegjës se nuk kanë mjete të mjaftueshme për shtrirjen e valëve në ato zona, ndërsa një konfirmim nga KFOR-i theksohet se në këtë zonë antenat egzistojnë dhe për shtrirjen e valëve nuk nevojitet shumë shpenzime. Ajo ishte e mendimi që si Komision duhet që sërish të merret ndonjë veprim.

Kryetarja – duke u bashkangjitur tha se është mirë që të ftohen përfaqësuesit e KPM-së dhe të diskutohet më gjerësisht për këtë çështje.

Kymete Bajraktari – Propozoi që në takimet e ardhëshme të Komisionit të jetë një pikë në rend të ditës që të diskutohet lidhur me raportin e trafikimit me qenie njerëzore sepse është shqetësuese ngritja e numrit të fëmijëve të trafikuar.

Kryetarja – Theksoi se në takimin e radhës do të vendoset si pikë e rendit të ditës ky raport dhe do të diskutohet lidhur me këtë.

Kimete Bytyqi – i njoftoi Komisionin se Grupi Punues për të drejtat e fëmijëve të hënen me 1. 7. 2013 do të vizitojë dy foshnjore në Prishtinë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali

